

INSTITUTI I KURRIKULAVE DHE STANDARDEVE

PROGRAM MËSIMOR PËR ARSIMIN E MESËM TË ULËT

LËNDA: HISTORIA E POPULLIT SHQIPTAR

(klasa e nëntë)

Tiranë, 2007

1. TË PËRGJITHSHME

Programi “Njohuri mbi historinë e popullit shqiptar” për klasën e IX-të të shkollës 9 - vjeçare përfshin studimin e zhvillimeve më të rëndësishme të shoqërisë njerëzore shqiptare dhe synon një trajtim sa më objektiv të tyre. Programi do të zhvillohet me dy orë në javë, gjithsej 70 orë vjetore, sipas planit mësimor të miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës. Prej të cilave 57 orë do të jenë njohuri të reja, 4 përsëritje, ndërsa 9 orë do të jenë orë të lira në dispozicion të mësuesit.

Programi është alternativ i temave me karakter përgjithësues, për problemet më të rëndësishme të zhvillimit botëror me temat historike të vendit tonë.

I parë në një këndvështrim të tillë, programi i ri në ndryshim nga paraardhësi përmban ndryshime të rëndësishme, si në strukturë ashtu edhe në përmbajtje. Disa karakteristika të këtij programi janë:

- Pasqyrimi i njohurive, aftësive dhe vlerave edukative, në formën e objektivave kryesore që duhet të përvetësojnë nxënësit në përfundim të studimit të lëndës, e cila përbën një ndryshim të rëndësishëm strukturor, duke ndihmuar mësuesin për një vlerësim sa më objektiv të arritjeve të nxënësit.
- Vendosja e një raporti të drejtë ndërmjet aspekteve të zhvillimeve politike, diplomatike nga njëra anë kundrejt atyre ekonomike, kulturore e sociale nga ana tjetër.
- Shtimi i numrit të orëve kushtuar studimit të popullit shqiptar që jeton jashtë kufijve shtetërorë të Shqipërisë, në vendet fqinje të rajonit të Ballkanit dhe më gjerë, duke synuar në këtë mënyrë rritjen e mëtejshme të mirëkuptimit, stabilitetit dhe të respektit të ndërsjellë ndërmjet popujve tanë, në funksion të aspiratës së tyre të përbashkët, anëtarësimit në Bashkimin Evropian.
- Numri i orëve të përsëritjes dhe atyre në dispozicion si dhe orët e veçanta për zhvillimin e testeve ndihmojnë në arritjen e objektivave të parashikuara.

Objekti i studimit të lëndës “Histori e popullit shqiptar” klasa IX, është zhvillimi i njeriut dhe i shoqërisë njerëzore shqiptare të shekullit XXI, i parë në të tërë dimensionet si ato civile, ekonomike, sociale, politike dhe fetare.

2. SYNIMI I LËNDËS

Në përfundim të studimit të kësaj lënde nxënësit duhet të jenë të aftë:

Kronologji

- Të rendisin ngjarjet, faktet, figurat dhe zhvillimet më të rëndësishme historike, ekonomike, sociale e politike të studiuara brenda kufijve kronologjikë të përfshirë në studim.
- të përdorin me përpikmëri terminologjinë e ngjarjeve dhe fenomeneve historike, të zhvillimeve historike në periudha të ndryshme të përfshira në studim si: Lidhja e Kombeve, epokë e bukur, diktaturë, totalitarizëm, fashizëm, komunizëm etj.

Gjerësia dhe thellësia e njohurive historike

- Të përshkruajnë dhe të shpjegojnë, përmbajtjen e koncepteve kryesore historike të përfshira në studim si: qytetërim perendimor, demokraci, ndërvarësi botërore, shtet totalitar, liberalizëm etj.

- Të përdorin fjalorin e duhur në përputhje me përmbajtjen e lëndës.
- Të përshkruajnë dhe të analizojnë, tiparet më karakteristike të zhvillimit të shoqërisë njerëzore shqiptare.
- Të shpjegojnë shkaqet dhe pasojat e ngjarjeve historike, situatave dhe ndryshimeve, të ndodhura në vendin tonë.
- Të vlerësojnë ndryshimet më të rëndësishme, që karakterizuan zhvillimin ekonomik, shoqëror e politik të shoqërisë shqiptare, si dhe rolin e figurave të ndryshme historike, në këtë drejtim.
- Të përshkruajnë disa nga arritjet më të rëndësishme shkencore, të artit, kulturës dhe teknologjisë, për periudhat e përfshira në studim.

Interpretimi historik

- Të tregojnë se për ngjarje, procese, e figura të ndryshme historike, ka interpretime të ndryshme.
- Të diskutojnë në mënyrë të argumentuar ndaj pikpamjeve të ndryshme, mbi zhvillimin historik të shoqërisë njerëzore shqiptare, duke dalluar faktet nga opinionet.
- Të analizojnë dhe të vlerësojnë në mënyrë kritike interpretimet, për ngjarje apo fenomene të ndryshme historike, duke arritur në kompromise mbi probleme të caktuara.
- Të interpretojnë tabllo, foto, harta historike, etj., për ngjarje, fakte ose dukuri historike të përfshira në studim.
- Të argumentojnë pikëpamjet e tyre, duke nxjerrë konkluzionet përkatëse mbi figurat, ngjarjet, faktet apo dukuritë historike të studiuara.

Kërkimi historik

- Të përdorin në mënyrë të pavarur burime të ndryshme informacioni si: dokumente historike, harta historike, foto, tabllo, për çështje të ndryshme historike.
- Të bëjnë pyetje në funksion të grumbullimit të informacionit të duhur, për çështje të ndryshme historike të përfshira në studim.
- Të hulumtojnë për të grumbulluar informacione të rëndësishme, nga burime të ndryshme historike të dorës së parë dhe të dytë, (harta, materiale të shkruara, ilustrime të ndryshme etj.) në funksion të çështjeve të përfshira në studim.

Organizimi dhe komunikimi

- Të përzgjedhin dhe të rendisin në mënyrë logjike, të dhënat dhe konceptet më të rëndësishme historike, për vendet dhe periudhat e studiuara.
- Të komunikojnë njohuritë dhe të kuptuarit e periudhave historike të studiuara, duke përdorur për këtë qëllim teknika të ndryshme si përshkrimin, shpjegimin etj.
- Të marrin pjesë në debate, ku nëpërmjet njohurive dhe aftësive të fituara, të kontribuojnë në arritjen e kompromiseve për probleme të caktuara.

4. OBJEKTIVA DHE TEMATIKA

Fushat tematike	Kreu/Objektivat	Konceptet	Numri i orëve
Tematika 1: PARAARDHËSIT E SHQIPTARËVE	<p>Në fund të klasës së nëntë nxënësit duhet të jenë të aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të tregojnë se kur kanë filluar të banohen trojet shqiptare. • Të përshkruajnë mënyrën e jetesës të të parëve tanë. • Të tregojnë qendrat e banuara prehistorike të vendit tonë. • Të përcaktojnë vendodhjen e ilirëve në Gadishullin e Ballkanit. • Të përshkruajnë disa nga virtytet e ilirëve. 	<p>Banorët e hershëm të vendit tonë.</p> <p>Ilirët.</p>	<p>2 orë</p>
Tematika 2: SHTETET ILIRE	<p>Në fund të klasës së nëntë nxënësit duhet të jenë të aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të përshkruajnë gjendjen ekonomike e shoqërore të fiseve ilire para krijimit të shtetit. • Të përcaktojnë dinastitë kryesore të mbretërive ilire dhe kohën e sundimit të tyre. • Të tregojnë disa nga veçoritë e zhvillimit ilir, nën drejtimin e dinastisë së Taulantëve dhe Adrianëve. • Të analizojnë shkaqet e fillimit të luftës romakëve kundër ardianëve, duke përcaktuar periudhën kur u zhvilluan këto luftra. • Të përcaktojnë kufijtë e shtetit të Epirit dhe rolin e fisit të molosëve në histori. • Të përshkruajnë mënyrën e qeverisjes në Epir dhe rolin e Pirros në këtë shtet. • Të tregojnë se ku shtrihej Mbretëria Dardane dhe të dallojnë emrat e disa fiseve e mbretërive dardane. • Të përshkruajnë marrëdhëniet e Mbretërisë Dardane me ardianët, maqedonasit dhe romakët. • Të përshkruajnë karakteristikat e artit parahistorik dhe 	<p>Mbretëritë e para ilire (të enkelejasve, taulantëve dhe ardianëve).</p> <p>Shteti i Epirit dhe Mbretëria Dardane.</p> <p>Arti dhe kultura. Iliria nën Perandorinë Romake.</p>	<p>3 orë</p>

	<p>ndryshimin që pësoi ai në periudhën qytetare ilire.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të rendisin disa të dhëna mbi kulturën ilire, gjuhën dhe paganizmin. • Të evidentojnë shkaqet e pushtimit romak, duke analizuar pasojat e këtij pushtimi për Ilirinë. • Të analizojnë rëndësinë e kryengritjeve 6-9 në Iliri. • Të përshkruajnë disa nga ndryshimet e jetës qytetare në Iliri pas pushtimit romak. 		
<p>Tematika 3:</p> <p>SHQIPËRIA NËN PERANDORINË BIZANTINE</p>	<p>Në fund të klasës së nëntë nxënësit duhet të jenë të aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të përcaktojnë vendin që zinin trojet shqiptare në Perandorinë Bizantine. • Të rendisin dhe analizojnë pasojat e dyndjeve sllave, në trojet e banuara nga shqiptarët. • Të argumetojnë vazhdimësinë iliro-shqiptare. • Të përshkruajnë ndryshimet kryesore, që solli zhvillimi i marrëdhënieve feudale. • Të përshkruajnë vendin dhe rolin e Principatës së Arbërit. • Të përshkruajnë tiparet më të rëndësishme të zhvillimit të marrëdhënieve feudale në qytete dhe fshatra. • Të rendisin disa nga elementet kryesore të vetqeverisjes së qyteteve. • Të përcaktojnë përmasat e ngulimeve shqiptare në Greqi në atë kohë. • Të përshkruajnë disa nga aspektet e zhvillimit të arsimit, letërsisë dhe fesë në mesjetë. 	<p>Shqipëria në shekujt e parë të mesjetës.</p> <p>Principata e Arbërit.</p> <p>Principatat shqiptare gjatë shek. XIV.</p> <p>Kultura, arti dhe shoqëria shqiptare në mesjetë.</p>	<p>3 orë</p>

<p>Tematika 4:</p> <p>EPOKA E GJERGJ KASTRIOTIT – SKËNDERBEUT</p>	<p>Në fund të klasës së nëntë nxënësit duhet të jenë të aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të përshkruajnë gjendjen e Shqipërisë dhe Ballkanit në prag të pushtimit osman. • Të tregojnë ecurinë e pushtimeve osmane në Ballkan dhe Shqipëri, duke evidentuar pasojat e tyre. • Të tregojnë shkaqet e kryengritjeve antiosmane në Shqipëri. • Të përcaktojnë shtrirjen e principatës së Kastriotëve dhe të flasin për rininë dhe karrierën e Skënderbeut. • Të vlerësojnë domosdoshmërinë e mbajtjes së Kuvendit të Lezhës, duke përshkruar vendimet që u morën në këtë kuvend. • Të përshkruajnë fitoret e para të Lidhjes Shqiptare të Lezhës, duke shpeguar rëndësinë që ato patën. • Të përshkruajnë zhvillimin e luftës së shqiptarëve kundër Venedikut. • Të përcaktojnë se kush ishin betejat e mëdha të Skënderbeut kundër osmanëve dhe si përfunduan ato. • Të përshkruajnë situatën e Shqipërisë pas vdekjes së Skënderbeut dhe betejat kryesore. • Të flasin për kthimin në Shqipëri të Skënderbeut të Ri dhe rimëkëmbjen e Principatës së Kastriotëve. • Të përshkruajnë rrjedhojat e pushtimit osman, duke nxjerrë në pah rëndësinë e epokës së Skënderbeut. 	<p>Sulmet e para osmane. Lidhja Shqiptare e Lezhës dhe fitoret e saj të para nën udhëheqjen e Gjergj Kastriotit-Skënderbeut.</p> <p>Betejat e mëdha.</p> <p>Marrëdhëniet e Skënderbeut në Evropë.</p> <p>Vazhdimësia e qëndresës antiosmane pas vdekjes së Skënderbeut.</p> <p>Rëndësia e epokës së Gjergj Kastriotit-Skënderbeut.</p>	<p>4 orë</p>
<p>Tematika 5:</p> <p>SHQIPËRIA NËN PUSHTIMIN E PERANDORISË OSMANE</p>	<p>Në fund të klasës së nëntë nxënësit duhet të jenë të aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të shpjegojnë sistemin e ri të timarit dhe pasojat e tij. • Të tregojnë rëndësinë që pati kryengritja e vitit 1537 dhe cili që qëllimi kryesor i kuvendeve shqiptare dhe atyre ballkanike. • Të përshkruajnë rolin e shkollave katolike në shek. VIII në 	<p>Lufta çlirimtare kundër sundimit osman në shek. XVI-XVII.</p> <p>Ndryshimet në ekonominë dhe shoqërinë shqiptare në</p>	<p>3 orë</p>

<p>(shek. XVI-XIX)</p>	<p>përhapjen e arsimit shqip</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të evidentojnë rëndësinë e veprave të shkrimtarëve shqiptarë në shek. VI-VII, duke përshkruar dhe tiparet e epikës legjendare. • Të përshkruajnë karakteristikat e ndërtimeve, si dhe të tregojnë tiparet kryesore të veprës së Onufrit. • Të shpjegojnë rrethanat në të cilat u krijua çifligu, duke evidentuar tiparet e tij. • Të përshkruajnë zhvillimin ekonomik të qyteteve shqiptare në shek. XVII-XVIII, si dhe të tregojnë përpjekjet e shqiptarëve për ruajtjen e gjuhës shqipe. • Të përshkruajnë gjendjen e kishës katolike dhe ortodokse pas pushtimit osman, duke argumentuar përhapjen e islamizmit në tokat shqiptare. • Të përshkruajnë përpjekjet shtetformuese, duke treguar si u krijua Pashallëku i Shkodrës dhe Janinës, si dhe të analizojnë shkaqet e rënies dhe rëndësinë e tyre. 	<p>shek. XVII-XVIII, bashkëjetesa fetare.</p> <p>Pashallëku i Shkodrës dhe i Janinës. Rëndësia e tyre.</p>	
<p>Tematika 6:</p> <p>RILINDJA KOMBËTARE SHQIPTARE (vitet 30 deri 1908)</p>	<p>Në fund të klasës së nëntë nxënësit duhet të jenë të aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të dallojnë dhe të përshkruajnë aspektet kryesore të reformës së Tanzimatit në perandorinë osmane, dhe qëllimin esaj. • Të nxjerrin në pah shkaqet se përse këto reforma, shkaktuan kryengritje në Shqipëri. • Të përkufizojnë se ç`kuptojnë me Rilindje Kombëtare Shqiptare duke përmendur disa nga rilindasit e pare. • Të rendisin synimet dhe projektet politike të shteteve fqinje, ndaj Shqipërisë. • Të argumentojnë pse ishte e nevojshme thirrja e një kuvendi të përgjithshëm shqiptar, duke evidentuar qëndrimin që mbajti Porta e Lartë. • Të rendisin vendimet e Kongresit të Berlinit, duke përshkruar ndikimin e këtyre vendimeve në Shqipëri. 	<p>Shqipëria gjatë periudhës së Tanzimatit. Rilindja kombëtare Shqiptare.</p> <p>Përmbajtja, etapat dhe karakteristikat e tyre.</p> <p>Rreziku i copëtimit të trojeve shqiptare nga fqinjët.</p> <p>Lidhja Shqiptare e Prizrenit</p>	<p>8 orë</p>

	<ul style="list-style-type: none"> • Të rendisin çështjet kryesore të platformës së Lidhjes së Prizrenit për pavarësi dhe të shpjegojnë acarimin e marrëdhënieve me Stambollin • Të tregojnë qëndrimin që mbajtën shqiptarët, mbi kërkesat e Lidhjes për autonominë e Shqipërisë. • Të shpjegojnë arsyet e mbledhjes së kuvendeve të Gjirokastrës dhe Dibrës, duke nxjerrë në pah rëndësinë e tyre. • Të shpjegojnë pse u formua qeveria e përkohshme e Prizrenit, masat që mori ajo, duke analizuar rëndësinë historike të saj? • Të tregojnë se në ç`rrethana u parashtruan kërkesat e reja për autonomi, pas rënies së Lidhjes së Prizrenit. Të argumentojnë rëndësinë që pati Lidhja e Pejës. • Të shpjegojnë shkaqet e pakënaqësisë së shqiptarëve në fillim të shek. XX. • Të tregojnë programet dhe veprimtarinë e komiteteve të fshehta dhe çetave patriotike në vitet 1901-1908. • Të shpjegojnë ndikimin që pati Lidhja e Prizrenit në lëvizjen kulturore, veçanërisht për arsimin kombëtar. • Të përmendin shoqëritë kryesore në diasporën shqiptare, duke evidentuar rolin e tyre në lëvizjen kombëtare. • Të përshkruajnë rrethanat e çeljes së Mësonjëtores shqipe të Korçës, duke nxjerrë në pah rolin që ajo pati. 	<p>Përpjekjet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit për formimin e shtetit shqiptar.</p> <p>Lufta e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit për ruajtjen e tërësisë tokësore të Shqipërisë Lidhja e Pejës.</p> <p>Lëvizja kombëtare shqiptare në vitet 1900-1908. Përhapja e shkollave dhe letrave shqiptare.</p>	
<p>Tematika 7:</p> <p>RRITJA E LËVIZJES KOMBËTARE DHE SHPALLJA E PAVARSISË SË SHQIPËRISË 1908-1912</p>	<p>Në fund të klasës së nëntë nxënësit duhet të jenë të aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të rendisin synimet që kishin turqit e rinj, duke shpjeguar ndikimin e revolucionit xhonturk në Lëvizjen Kombëtare shqiptare • Të shpjegojnë arsyet pse u mbajt Kongresi i Manastirit dhe ai i Elbasanit, duke renditur vendimet kryesore të këtyre kongreseve. Të argumentojnë rëndësinë e Kongresit të Dibrës. • Të shpjegojnë shkaqet e shpërthimit të kryengritjes së vitit 1910 	<p>Lëvizja kombëtare shqiptare dhe turqit e rinj.</p> <p>Kryengritja e përgjithshme e vitit 1912.</p> <p>Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë.</p>	<p>3 orë</p>

	<p>dhe 1911 dhe rëndësinë e tyre.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të përshkruajnë se si u përgatit kryengritja e vitit 1911 dhe të argumentojnë pse ajo mori karakter kombëtar. Memorandumi i Grecës. • Të nxjerrin në pah karakterin e Luftës së parë Ballkanike, duke evidentuar qëndrimin e shqiptarëve ndaj saj. • Të shpjegojnë si u kalua nga platforma autonomiste në atë të pavarësisë, duke treguar rëndësinë që pati për Shqipërinë dhe shqiptarët shpallja e Pavarësisë. 		
<p>Tematika 8:</p> <p>SHQIPËRIA DHE VISET E TJERA SHQIPTARE JASHTË KUFIJVE NË VITET 1912-1924</p>	<p>Në fund të klasës së nëntë nxënësit duhet të jenë të aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të përshkruajnë rrethanat në të cilat u formua qeveria e Ismail Qemalit, qëndrimin që mbajti ajo ndaj Luftës Ballkanike dhe masat e saj në fushën arsimore dhe ekonomike. • Të përshkruajnë vendimin e Konferencës së Ambasadorëve në Londër, për kufijtë dhe njohjen e pavarësisë së Shqipërisë. • Të tregojnë format e dhunës e të terrorit serbo-malazez që shkaktuan kryengritjet shqiptare në vitin 1913 e më pas. • Të përshkruajnë qëndrimin që mbajti qeveria e Vidit pas caktimit të kufijve të Shqipërisë, veçanërisht qëndrimin e saj me lëvizjen vorio-epirioete. • Të shpjegojnë rrethanat e ardhjes së princ Vidit në Shqipëri, veçanërisht për statusin organik të Shqipërisë. Të shpjegojnë shkaqet e rebelimit sadist, grekoman dhe turkoman. • Të flasin për pushtimin e Shqipërisë dhe viseve të tjera shqiptare gjatë Luftës I-rë Botërore, duke nxjerrë në pah detyrat e Lëvizjes Kombëtare shqiptare gjatë kësaj lufte. • Të argumentojnë pse ishte e domosdoshme thirrja e Kongresit Kombëtar të Lushnjës dhe të përshkruajë vendimet e tij. • Të nxjerrin në pah arsyet e fillimit të Luftës së Vlorës dhe rëndësinë që ajo pati për sovranitetin e Shqipërisë. • Të dallojnë se me ndihmën e kujt u ripushtua Kosova dhe të 	<p>Qeveria Kombëtare e Vlorës e kryesuar nga Ismail Qemali.</p> <p>Lufta për çlirimin e bashkimin kombëtar në viset e pushtuara nga Serbia dhe Mali i Zi (1912-1915).</p> <p>Lufta kundër shovinizmit grek.</p> <p>Shqipëria gjatë regjimit të Vidit.</p> <p>Pëpjekjet për shkatërrimin e shtetit shqiptar.</p> <p>Shqipëria, Kosova dhe viset e tjera shqiptare gjatë Luftës së I - rë Botërore.</p> <p>Kongresi i Lushnjës.</p>	<p>8 orë</p>

	<p>përshkruajnë rolin që luajti “Mbrotjtja Kombëtare e Kosovës”.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të përshkruajnë situatën e pas Luftës I-rë Botërore dhe përpjekjet e shqiptarëve për forcimin e pozitave të shtetit shqiptar në vitet 1920-1923. • Të shpjegojnë shkaqet e Lëvizjes së Qershorit 1924, të përshkruajnë programin e Qeverisë së F. Nolit, duke evidentuar rëndësinë që ai pati. 	<p>Lufta e Vlorës.</p> <p>Shqipëria në vitet 1920-1923</p> <p>Lëvizja e Qershorit 1924.</p>	
<p>Tematika 9:</p> <p>SHQIPËRIA GJATË REGJIMIT TË AHMET ZOGUT</p>	<p>Në fund të klasës së nëntë nxënësit duhet të jenë të aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të shpjegojnë shkaqet e shpalljes së Republikës dhe Statutin themeltar të saj. • Të dallojnë hapat që u ndërmorën për zhvillimin kapitalist të vendit. • Të rendisin faktet historike kur dhe pse u shpall Mbretëria, duke përshkruar kompetencat e mbretit, parlamentit si dhe masat që u morën për vendosjen e shtetit ligjor. • Të flasin për marrëveshjet italo-shqiptare dhe të shpjegojnë pasojat e tyre. • Të përshkruajnë nivelin e jetës qytetare dhe arritjet në fushën e arsimit, arteve dhe letërsisë. 	<p>Republika shqiptare 1925-1928</p> <p>Mbretëria shqiptare 1928-1939</p> <p>Lëvizjet me karakter politik, shoqëror e kulturor.1925-1939.</p>	<p>3 orë</p>
<p>Tematika 10:</p> <p>GJENDJA E SHQIPTARËVE NË JUGOSLLAVI DHE GREQI 1925-1940</p>	<p>Në fund të klasës së nëntë nxënësit duhet të jenë të aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të shpjegojnë qëllimin e reformës agrare për kolonizimin e Kosovës dhe shpronësimin e shqiptarëve. • Të përcaktojnë synimet e platformës së shpërnguljes së shqiptarëve dhe drejtimin e shpërnguljes së tyre. • Të analizojnë faktorët që ndikuan në dështimin e platformës së shpërnguljes dhe shkombëtarizimit. • Të përshkruajnë format karakteristike të qëndresës së shqiptarëve dhe të shpjegojnë rezultatet e kësaj qëndrese 	<p>Shpronësimi dhe shpërngulja me dhunë e shqiptarëve në Jugosllavi.</p> <p>Shpronësimi dhe shpërngulja me dhunë e shqiptarëve, në Greqi në vitet 1924-1940</p>	<p>2 orë</p>

<p>Tematika 11:</p> <p>PUSHTIMI NAZIFASHIST DHE LUFTA E POPULLIT SHQIPTAR KUNDËR TIJ</p>	<p>Në fund të klasës së nëntë nxënësit duhet të jenë të aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të rendisin masat që ndërmori Italia fashiste për pushtimin e Shqipërisë dhe të përshkruajnë vendosjen e regjimit të pushtimit fashist në Shqipëri. • Të flasin për qëndresën e shqiptarëve kundër pushtimit fashist. • Të analizojnë programin e PKSH dhe BK si dhe platformën e Konferencës së Pezës. • Të tregojnë aksionet më të rëndësishme luftarake të shqiptarëve në vitet 1939-1942. • Të rendisin tiparet e Luftës Çlirimtare Antifashiste Shqiptare kundër fashizmit italian. • Të flasin për pushtimin gjerman në Shqipëri dhe të përshkruajnë veçoritë e politikës së tij në Shqipëri. • Të tregojnë qëndrimin e forcave politike ndaj pushtimit gjerman. • Të përshkruajnë operacionet luftarake të gjermane në dimër dhe në pranverë, përfundimin e tyre. • Të përshkruajnë disa nga episodet vendimtare të luftës për çlirimin e Tiranës dhe të gjithë Shqipërisë. • Të analizojnë karakterin e luftës së shqiptarëve kundër pushtuesve italian e gjerman dhe rezultatet e kësaj lufte. • Të rendisin vendimet e Konferencës së Bujanit dhe të përshkruajnë luftën antifashiste në Kosovë duke nxjerrë në pah ndërhyrjen të udhëheqjes jugosllave. • Të analizojnë luftën antifashiste në Çamëri dhe përpjekjen e grekëve për të minimizuar këtë luftë. 	<p>Pushtimi fashist i Shqipërisë.</p> <p>Organizimi dhe veprimet luftarake kundër pushtuesve fashist italian.</p> <p>Vendosja e regjimit nazist gjerman të pushtimit.</p> <p>Zgjerimi i Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare.</p> <p>Çlirimi i Shqipërisë, bilanci, rëndësia dhe kontributi i popullit shqiptar gjatë Luftës së Dytë Botërore.</p> <p>Lufta Antifashiste në Kosovë e vise të tjera shqiptare.</p> <p>Lufta Antifashiste e popullit çam kundër fashizmit</p>	<p>7 orë</p>
<p>Tematika 12:</p> <p>SHQIPËRIA GJATË</p>	<p>Në fund të klasës së nëntë nxënësit duhet të jenë të aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të përshkruajnë masat që u morën për vendosjen e regjimit komunist, duke evidentuar karakteristikat e regjimit që u vendos. 	<p>Vendosja e regjimit komunist</p> <p>Marrëdhëniet e Shqipërisë</p>	

REGJIMIT KOMUNIST	<ul style="list-style-type: none"> • Të analizojnë masat kryesore të qeverisë kundër pronës private dhe drejtimet themelore të zhvillimit të arsimit e kulturës. • Të përshkruajnë qëndresën e forcave demokratike dhe antikomuniste ndaj regjimit politik në Shqipëri. • Të shpjegojnë orientimin ndaj politikës së vendeve lindore dhe faktorët që përcaktuan këtë orientim në Shqipëri. • Të shpjegojnë zbatimin e sistemit stalinist për ngritjen e industrisë dhe kolektivizimin e fshatit. • Të analizojnë marrëdhëniet me Jugosllavinë dhe Bashkimin Sovjetik dhe motivet e prishjes së këtyre marrëdhënieve. • Të rendisin dukuritë më tipike të politizimit dhe idealizimit të skajshëm të jetës së vendit. • Të shpjegojnë keqësimin e marrëdhënieve të Shqipërisë me botën e jashtme , duke treguar tiparet e politikës së vetizolimit të shtetit komunist. 	<p>me vendet e tjera(1945-48)</p> <p>Zbatimi i modelit stalinist në Shqipëri.</p> <p>Politika e jashtme e Shqipërisë.(1948-1960)</p> <p>Forcimi i represionit të regjimit komunist.</p> <p>Vetizolimi i shtetit komunist.(1978-1990)</p>	
Tematika 13: SHQIPTARËT NË JUGOSLLAVI E BOTË PAS LUFTËS DYTË BOTËRORE	<p>Në fund të klasës së nëntë nxënësit duhet të jenë të aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të analizojnë politikën shkombëtarizuese dhe shpërngulësisë të qeverisë jugosllave ndaj shqiptarëve. • Të shpjegojnë pasojat që pati për shqiptarët në Jugosllavi prishja e marrëdhënieve me BS dhe Jugosllavinë. • Të analizojnë rëndësinë e Plenumit të Brionëve për shqiptarët në Kosovë. • Të rendisin kërkesat e intelektualëve shqiptarë të Kosovës për Kushtetutën e vitit 1968 dhe të përshkruajnë arsyet e demonstratave të këtij viti. • Të përshkruajnë si u arrit avancimi i autonomisë së Kosovës në 1974. • Të rendisin kërkesat e shqiptarëve në 1981 për “Kosova republikë” dhe përshkruajnë forcimin e dhunës ndaj shqiptarëve. • Të analizojnë Lëvizjen Demokratike në Kosovë në vitet 1989-1992, që lindi nga qëndrimi i Serbisë për krijimin e “Serbisë 	<p>Kosova në vitet 1945-1948.</p> <p>Shqiptarët në Kosovë në vitin 1949-1974.</p> <p>Shqiptarët në Kosovë në vitin 1974- 2000.</p> <p>Diaspora shqiptare 1944-1990.</p>	<p>4 orë</p>

	<p>Unike” e përfundoi me deklaratën Kushtetuese dhe Kushtetutën e Republikës së Kosovës më 1990</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të flasin për veprimtarinë e diasporës shqiptare në botë dhe figurat më të rëndësishme të saj 		
<p>Tematika 14:</p> <p>RENIA E REGJIMIT KOMUNIST FITORJA E SISTEMIT DEMOKRATIK</p>	<p>Në fund të klasës së nëntë nxënësit duhet të jenë të aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të analizojnë disa nga tiparet e krizës ekonomike, kryesisht në bujqësi dhe industri. • Të analizojnë disa nga masat që mori qeveria komuniste gjatë periudhës që ishte në pushtet. • Të përshkruajnë disa nga momentet kryesore të shprehjes së pakënaqësisë popullore kundër diktaturës komuniste. • Të shpjegojnë rrethanat e krijimit të Partisë Demokratike dhe të përshkruajnë platformën e programit të saj. • Të përshkruajnë shpërthimin e Lëvizjes Demokratike në të gjithë vendin, faktorët që çuan në zgjedhjet e 22 marsit 1992, fitoren e forcave demokratike. 	<p>Kriza e rregjimit komunist.</p> <p>Shqipëria nga viti 1992 deri në vitin 2000.</p>	<p>2 orë</p>

5. SHPERNDARJA E OREVE

Në klasën IX të arsimit të detyruar 9 – vjeçar, historia do të zhvillohet në 35 javë mësimore me 2 orë në javë, gjithsej 70 orë mësimore.

35 javë x 2 orë/ javë = 70 orë vjetore

KURRIKULA ZYRTARE	Sasia e orëve
Paraardhësit e shqipëtarëve.	2
Shtetet ilire.	3
Shqipëria në Perandorinë Bizantine.	3
Epoka e Gjergj Kastriot – Skënderbeut.	4
Vendosja e sundimit osman në trojet shqiptare.	3
Rilindja Kombëtare Shqiptare.	8
Rritja e Lëvizjes Kombëtare. Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë.	3
Shqipëria dhe viset etnike në vitet 1912 – 1924.	8
Shqipëria gjatë regjimit të A. Zogut.	3
Gjendja e shqiptarëve të Jugosllavisë e Greqisë 1925 – 1940.	2
Pushtimi fashist dhe lufta e popullit shqiptar kundër tij.	7
Shqipëria gjatë regjimit komunist.	5
Shqiptarët në Jugosllavi dhe Botë pas Luftës së II - të Botërore.	4
Rënia e Regjimit komunist. Fitorja e demokracisë.	2
Përsëritje.	4
Kurrikula e lirë në dispozicion të mësuesit	9

6. ZBATIMI I KURRIKULËS SË LIRË

Qëllimi i orëve të lira (15% e orëve totale) është t'i lërë hapësirat e nevojshme iniciativës dhe krijimtarisë së shkollës, për të përmbushur sa më mirë nevojat dhe interesat e nxënësve, në përputhje me, objektivat e programit zyrtar të miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe të përparësive që vendos mjedisi i veçantë, në të cilin zhvillohet procesi i arsimit.

Statusi i tyre është sa i detyrueshëm aq edhe fleksibël. Është i detyrueshëm sepse duhen zhvilluar deri në fund të vitit shkollor. Është fleksibël sepse shpërndarja përgjatë vitit dhe mbushja me material mësimor, është kompetencë e mësuesit të lëndës në bashkëpunim me Drejtorinë Arsimore, Drejtorinë e shkollës dhe me mësuesit e tjerë të shkollës.

Për mbushjen e orëve të lira me material mësimor, mund të përdoren burime të ndryshme informacioni, por gjithmonë të bëhet kujdes, që këto burime të shërbejnë, në arritjen e kërkesave të programit. Gjithashtu kujdes duhet patur, në përzgjedhjen e këtyre materialeve në mënyrë që, këto burime e fakte historikë të grumbulluara nga mësuesit apo vetë nxënësit, për zhvillimin e orëve të lira, tu referohen burimeve të zyrtarizuara dhe të kenë vërtetësi shkencore.

Grumbullimi i fakteve, shifrave e të dhënave të ndryshme historike, gjeografike, demografike, kulturore, industriale, bujqësore, mund të kthehen në burime të vlefshme për të organizuar orë mësimore interesante.

Organizimi i ekskursioneve në natyrë, të shoqëruara me veprimtari praktike; organizimi i vizitave në qendra të ndryshme prodhimi, të shoqëruara me vrojtime dhe të pasuara me detyra, në shërbim të një objektivi të caktuar të programit; organizimi i konkurseve brenda klasës, lojra të ndryshme zbavitëse, me elementë që zhvillojnë të menduarin logjik dhe kritik, përforcimi i njohurive i shoqëruar me metoda e strategji që fuqizojnë si të nxënësit ashtu edhe mësuesin, janë disa veprimtari rekomanduese për rubrikën e orëve të lira.

Për mbushjen efikase të një pjese të orëve të lira mund të bashkëpunohet edhe me mësues të lëndëve të tjera, duke hartuar paraprakisht një plan të përbashkët disa orësh, që shfrytëzon lidhjet konceptuale ndër-lëndore dhe aspektet kroskurrikulare. Nxënësve u jepet një detyrë e cila përfshin njohuri ndër-lëndore dhe i shërbën arritjes së objektivave të programeve të disa lëndëve dhe objektivave kroskurrikulare.

Shpërndarja dhe larmia e veprimtarive, duhet të bëhet duke analizuar me kujdes si programin edhe kërkesat që parashtrojnë veçoritë vendore.

Kujdes duhet bërë që orët e lira të mos shpërdorohen duke i shfrytëzuar për qëllime rutinë të cilat nuk sjellin risi të reja në kurrikulin shkollor.

Realizimi i sugjerimeve të mësipërme kërkon nga mësuesi jo vetëm aftësi krijuese, por dhe aftësinë e një krijuesi të vërtetë kurrikule, për rrjedhojë dhe përgjegjësinë profesionale dhe qytetare që bart me vete ky rol.

7. INTEGRIMI

Historia duhet të zhvillohet në lidhje të ngushtë me lëndët e tjera. Lënda e historisë dhe lëndët e tjera duhet të ndihmojnë në mënyrë të ndërsjellë njëra-tjetrën. Vetëm në këtë mënyrë do të mund të realizohen si duhet edhe objektivat kryesorë të shkollës dhe të shoqërisë në fushën e arsimit.

Çfarë do të thotë kjo?

- Së pari, historia mund të shfrytëzojë informacionin dhe çështjet që trajtohen në lëndët e tjera për të sqaruar, për të konkretizuar dhe për të argumentuar më mirë objektivat e saj.
- Së dyti, lëndët e tjera duhet të shfrytëzojnë përmasën dhe këndvështrimin e historisë për të aktualizuar dhe për të kuptuar më mirë çështjet e tyre në diskutim, si dhe për të nxitur përgjegjësinë dhe motivimin qytetar të nxënësve në shkollë dhe në bashkësinë ku jetojnë

Shembuj

I. Edukimi Qytetar dhe Historia

Lënda e historisë dhe ajo e edukimit qytetar kanë të përbashkët:

1. **Konceptet** psh : pushteti, autoriteti, ligji, qeverisja, përfaqësimi, liria, etj.
2. **Aftësitë dhe shprehjet** psh: përshkrimi, analiza, shpjegimi, diskutimi, kërkimi, interpretimi etj

Historia:

- U jep aktualitet më të madh çështjeve me të cilat merret edukimi qytetar. Në këtë mënyrë, ajo i ndihmon nxënësit të kuptojnë rëndësinë e edukimit qytetar për jetën e tyre të përditshme.

Si mund të realizohet lidhja ndërmjet lëndës së historisë dhe edukimit qytetar?

1. Së pari kjo lidhje mund të realizohet nëpërmjet përfshirjes së çështjeve, fakteve, ngjarjeve, të trajtuara në lëndën e edukimit qytetar, dhe që janë pjesë e kurrikulës së historisë, me kusht që përmasa e mësimin të historisë duhet:

- Të jetë çështja thelbësore e mësimin;
- Të lidhet me kurrikulën e edukimit qytetar;

2. Së dyti, objektivat mësimorë duhet të shprehen qartë dhe të jenë pjesë e kurrikulës kombëtare të historisë. Kështu, lidhja ndërmjet tyre mund të realizohet përmes elementeve të mëposhtëm

- **Konceptet:** Karakteristikat e koncepteve (si drejtësia, barazia, liria etj) duhet të shpjegohen në kohë dhe në hapësirë, pra në kontekste konkrete që lidhen me jetën e përditshme të njeriut, në të kaluarën dhe në të sotmen.
- **Tema:** Në disa mësim mund të theksohet përmasa e qytetarisë, si për shembull, në çështjet e të drejtave të njeriut.
- **Fusha kurrikulare:** Rishqyrtimi i vazhdueshëm i çështjeve të tilla si demokraci, qytetari, etj., të cilat përshkruajnë kurrikulën gjatë gjithë ciklit të shkollimit.
- **Përmasa vendore:** historia duhet të ndihmojë në rritjen e pjesëmarrjes qytetare në jetën e bashkësisë, për shembull, duke ndërmarrë projekte, ku mund të përfshihen breza të ndryshëm.

3. Së treti, historia ndihmon në edukimin qytetar, kur ajo përdoret në debatet për çështje dhe ngjarje të rëndësishme historike, duke arritur në kompromise mbi probleme të caktuara, e cila nxit te nxënësit të mësuarin në mënyrë kritike.

II. Gjeografia dhe historia

1. Çfarë kanë të përbashkët Gjeografia dhe historia? Ato kanë të përbashkët:

- **Konceptet:** mjedis, të drejtat e njeriut, bashkësia, ndërvarësia etj.,
- **Përmbajtjen:** bota si bashkësi globale, sfidat e ndërvarësisë globale etj,

2. Si mund tëndihmojë lënda e gjeografisë në trajtimin e çështjeve të lëndës së historisë:

- Ndhmon nxënësit të kuptojnë më mirë ndikimin e veprimtarisë ekonomike tek njerëzit dhe të bashkësisë ku ata jetojnë.
- Nxjerr në pah marrëdhëniet ndërmjet zhvillimeve vendore, kombëtare dhe globale.
- Nxjerr në pah mundësinë e qytetarëve për të ndikuar në jetën e bashkësisë dhe më gjerë.
- Shqyrton në gjerësi dhe në thellësi çështje të zhvillimit të qendrueshëm.
- Nxit respektin për njerëz dhe kultura të tjera si dhe për mjedisin ku ata jetojnë dhe bashveprojnë.

3. Në ç 'mënyrë lënda e historisë ndihmon në zhvillimin e lëndës së gjeografisë?

- Zbulon lidhjet e çështjeve me të cilat merret lënda e gjeografisë, si mjedisi dhe njeriu, duke treguar bashveprimin e këtyre faktorëve në periudha të ndryshme historike, me qëllim rritjen e interesit të nxënësve për këto element.
- Ndhmon nxënësit të kuptojnë rëndësinë e lëndës së gjeografisë.
- Nxit të kuptuarit e çështjeve që lidhen me zhvillimin, ekonomik të një vendi, për shembull, tregtinë, turizmin, transportin etj.
- Nxit nxënësit të marrin pjesë në zhvillimin e projekteve të ndryshme në bashkësinë ku ata jetojnë, për shembull, në çështje mjedisore.

Si mund të realizohet lidhja ndërmjet lëndës së gjeografisë dhe historisë?

1. Së pari, mësimet e gjeografisë kanë si pjesë përbërëse dhe objekt studimi mjedisin natyror. Ato duhet të lidhen me konceptet e zhvillimit të shoqërisë njerëzore, qytetarisë, si për shembull, me lidhjet e ndërsjellta midis elementëve natyror dhe shoqëror të mjedisit dhe pasojat e tyre, si dhe të përfshijnë veprimtari të tilla si diskutimet etj.

2. Së dyti, përmasa e mësimet të historisë gjatë zhvillimit të temave të historisë duhet:

- Të jetë çështja thelbësore e mësimet;
- Të lidhet me kurrikulën e gjeografisë;

III. Shkenca dhe historia

Shoqëria e sotme, vazhdimisht shtron përpara nesh çështje që lidhen me jetën tonë si në plan vetjak ashtu edhe në plan shoqëror. Trajtimi dhe zgjidhja e këtyre çështjeve, shpesh herë, kërkon jo vetëm njohuri shkencore, por edhe aftësitë dhe shprehjet e duhura, për t'u përfshirë në diskutime dhe veçanërisht për të dhënë gjykime kritike të argumentura saktë dhe drejtë.

Cilat janë të përbashkëtat ndërmjet shkencës dhe historisë?

- Çështje të ndryshme rreth shkencës dhe mjedisit, për shembull, çështja e ngrohjes globale.
- Ndikim i përparimeve teknike në shoqëri dhe qytetërimin botëror, për shembull, ndikim i internetit.
- Kontrolli i shkencës, për shembull, shpërndarja e fondeve për kërkime shkencore (do të përdorim miliarda lekë për të provuar që ka jetë në Mars, apo do t'i përdorim këto lekë për qëllime të tjera më të rëndësishme për shoqërinë e sotme?).

Lënda e historisë duhet të ndihmojë nxënësit:

- të reflektojnë dhe të diskutojnë për rrjedhojat shoqërore, të zhvillimeve shkencore.
- të vlerësojnë rolin qendror të shkencës në botën e sotme dhe përparësitë që zhvillimi i saj sjell në qytetërimet botërore dhe shoqëri.
- të kuptojnë karakterin kontradiktor të shkencës dhe faktin që shkencëtarët kanë pikëpamje të ndryshme dhe kundërshtuese si për faktet që përdoren në shkencë ashtu edhe për rreziqet që rrjedhin prej zhvillimeve shkencore.

Autorët e teksteve dhe mësuesit, si përdoruesit kryesorë të programit të lëndës së historisë, duhet të përpiqen ose të kenë prirjen, për të mbajtur parasysh mundësitë e lidhjes së kësaj lënde me lëndët e tjera. Realizimi në praktikë i kësaj lidhjeje, jo vetëm do të ndihmonte në pasurimin e argumenteve dhe burimeve historike, por duke ritheksuar lidhjen e mësimit të historisë me aspekte të ndryshme të realitetit, do të rriste edhe motivimin dhe interesin e nxënësve për këtë lëndë dhe shkollën në përgjithësi.

Mësuesit duhet të zgjedhin me kujdes pjesë nga kurrikula e shkencave të natyrës dhe të përcaktojnë jo vetëm objektivat e të nxënësve por edhe mënyrën për t'i zbatuar ato qartësisht tek nxënësit.

8. METODOLOGJIA E ZBATIMIT TË PROGRAMIT

Përzgjedhja e metodave mësimore bëhet nga vetë mësuesi në përshtatje më veçoritë e temave të ndryshme mësimore. Një harmonizim i drejtë i këtyre metodave lehtëson realizimin e objektivave të lëndës të parashikuar nga programi mësimor, duke nxitur një mësimdhënie dhe nxënie të sukseshme, për të gjitha nivelet e nxënësve.

Metodat dhe teknikat e mësimdhënies dhe mësimnxënies që mund të zbatohen gjatë një ore mësimi, janë të shumta. Si të tilla mund të përdoren **shpjegimi**, i cili mund të jetë i suksesshëm, në të gjitha ato veprimtari të përbashkëta të mësuesit e nxënësve, që synojnë të kuptuarit e njohurive, për zhvillimin në kohë e në hapësirë të dukurive e proceseve historike, **mësimi zbulues** nëpërmjet të cilit kalohet nga njohuritë elementare në përgjithësime, nga hipotezat në gjetjen e origjinës së dukurive, nga problemet e thjeshta në zgjidhjen e tyre, **biseda**, e cila do të ishte më e efektshme për ato tema ku nxënësit kanë njohuri paraprake të bollshme që fitohen nëpërmjet rrugëve të shumta të informacionit masiv, **diskutimi** i cili të çon në zgjidhjen e problemit etj. Gjithnjë duhet mbajtur parasysh faktin se përdorimi i shpeshtë i metodave problemore e kërkimore, shmang të mësuarin pasiv dhe mekanik të nxënësve.

Përdorimi i suksesshëm i metodave dhe teknikave të lartpërmendura nuk mund të realizohet pa mjetet e nevojshme didaktike, të cilat janë të llojeve të ndryshme, si: harta historike të përgjithshme apo tematike, atlasë, albume, foto, skica, filma mësimorë, videokaseta etj.

9. VLERËSIMI

Vlerësimi i nxënësve të jetë sistematik dhe i larmishëm. Ai të përfshijë konceptet dhe njohuritë më të rëndësishme, që duhet të përvetësojë nxënësi, duke shmangur hollësitë e panevojshme.

Vlerësimi sistematik, semestral apo vjetor, mund të realizohet nëpërmjet teknikave të ndryshme, si: me shkrim, me gojë (pjesërisht apo frontalisht), testimet etj. Në rastet kur zbatohen testet, të mbahen parasysh këta elementë:

- Nxënësit duhet të jenë familjarizuar që më parë me këtë teknikë vlerësimi.
- Testi të përfshijë objektivat më kryesore, të programit, ndërsa shkalla e vështirësisë të jetë në përshtatje, me nivelin e përvetësimit të njohurive historike nga nxënësit..
- Të hartohet nga vetë mësuesi një sistem i thjeshtëzuar pikëzimi. Në këtë rast të mbahen parasysh disa nga cilësitë më kryesore të tij, si: vlefshmëria, besueshmëria, objektiviteti dhe përdorshmëria. Përveç regjistrimit të klasës, njohja dhe vlerësimi i njohurive të fituara nga nxënësit, plotësohet më tej edhe nga shënimet vetjake të mësuesit.

Mbajtja e shënimeve për gabimet tipike të nxënësve dhe mangësitë me karakter të ndryshëm që ata kanë për njohuri e shprehje të veçanta, do ta ndihmonte mësuesin në planifikimin më të mirë të veprimtarive didaktike të ardhshme në dobi të arritjes së objektivave për të gjithë nxënësit.

Kujdes i veçantë të tregohet në qortimin dhe vlerësimin e detyrave të nxënësve, sidomos të punimeve që plotësohen hap pas hapi gjatë veprimtarive të pavarura. Në këto raste, mësuesi të shënojë me hollësi natyrën e gabimeve të mundshme, të shoqëruara këto me sqarimet përkatëse, por edhe të demonstrojë para klasës punimet më të mira duke i komentuar ato.